



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2023-12  
**Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

**Vendosi:** Gjykatësja e Procedurës Paraprake  
Gjykatëse Marzhori Masëlo

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 3 tetor 2025

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendimi i Pestë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut**

---

**Prokurores së Specializuar**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**  
Sofi Menegon  
Luka Mishetiq

**Mbrojtjes së Bashkim Smakajt**  
Xhonatan Ris  
Hju Bauden

**Mbrojtjes së Isni Kilajt**  
Ian Eduards  
Xho Holms

**Mbrojtjes së Fadil Fazliut**  
Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Hajredin Kuçit**  
Aleksandër Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,<sup>1</sup> në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 dhjetor 2024, Fadil Fazliu ("z. Fazliu" ose "i akuzuari") u arrestua në Kosovë<sup>2</sup> në bazë të vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake<sup>3</sup> dhe në vijim të konfirmimit të aktakuzës kundër tij, Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Bashkim Smakajt, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit ("Vendimi i Konfirmimit").<sup>4</sup>
2. Më 8 dhjetor 2024, në paraqitjen e parë të z. Fazliu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, [Decision Assigning a Pre-Trial Judge](#) (Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake), 6 qershor 2024, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2023-12, F00045, Administratorja, [Notification of Arrest of Fadil Fazliu Pursuant to Rule 55\(4\)](#) (Njoftim i Arrestimit të Fadil Fazliut sipas Rregullës 55(4)), 5 dhjetor 2024, publik.

<sup>3</sup> KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse* ("Vendimi i Arrestimit"), 29 nëntor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik i parashtrimin kryesor u lëshua më 19 dhjetor 2024, [F00037/RED](#).

<sup>4</sup> KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 12 shkurt 2025, [F00036/RED](#). Vendimi i Konfirmimit më pas u ndryshua, por ndryshimet nuk ishin në lidhje me z. Smakaj; *shih* KSC-BC-2023-12, F00260, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Amending the "Decision on the Confirmation of the Indictment" and Setting a Date for the Submission of Preliminary Motions](#) (Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake), 14 prill 2025, publik.

<sup>5</sup> KSC-BC-2023-12, Transkripti i seancës ("Transkripti i Paraqitjes së Parë"), 8 dhjetor 2024, publik, f. 65, rreshti 24, deri në f. 69, rreshti 18; *shih, veçanërisht*, f. 68, rreshtat 8-9 ("Vendimi për Paraburgimin").

3. Më 7 shkurt 2025,<sup>6</sup> 7 prill 2025,<sup>7</sup> 5 qershor 2025<sup>8</sup> dhe 5 gusht 2025 (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit"),<sup>9</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Smakaj.
4. Më 29 gusht 2025, Mbrojtja e z. Fazliu ("Mbrojtja e Fazliut") dorëzoi parashtrime në lidhje me rishikimin e paraburgimit të tij ("Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut").<sup>10</sup>
5. Më 10 shtator 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi përgjigjen ("Përgjigjja e ZPS-së").<sup>11</sup>
6. Më 15 shtator 2025, Mbrojtja e Fazliut dorëzoi kundërpërgjigjen ("Kundërpërgjigjja e Fazliut").<sup>12</sup>

## II. PARASHTRIMET

### A. PARASHTRIMET E MBROJTJES SË FAZLIUT

7. Mbrojtja e Fazliut kërkon lirimin me kusht të z. Fazliu deri në shqiptimin e aktgjykimit, ose të paktën deri në fillim të gjykimit,<sup>13</sup> duke argumentuar se nuk ka arsye të artikulueshme për të besuar se z. Fazliu mund të arratiset, të pengojë

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2023-12, F00163, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Review of Detention of Fadil Fazliu](#) ("Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut") ("Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit"), 7 shkurt 2025, publik.

<sup>7</sup> KSC-BC-2023-12, F00251, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut*, ("Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit"), 7 prill 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, [F00251/RED](#).

<sup>8</sup> KSC-BC-2023-12, F00327, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Third Decision on Review of Detention of Fadil Fazliu](#) (Vendimi i Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut) ("Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit"), 5 qershor 2025, publik.

<sup>9</sup> KSC-BC-2023-12, F00404, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Fourth Decision on Review of Detention of Fadil Fazliu](#) (Vendimi i Katërt mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut), 5 gusht 2025, publik.

<sup>10</sup> KSC-BC-2023-12, F00428, Mbrojtja e Fazliut, *Parashtrime të Mbrojtjes së Fazliut në lidhje me Rishikimin e Pestë të Paraburgimit*, 29 gusht 2025, konfidenciale, me Shtojcat 1-3, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 4 shtator 2025, F00428/RED.

<sup>11</sup> KSC-BC-2023-12, F00447, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut në lidhje me Rishikimin e Pestë të Paraburgimit*, 10 shtator 2025, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 15 shtator 2025, F00447/RED.

<sup>12</sup> KSC-BC-2023-12, F00452, Mbrojtja e Fazliut, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Fazliut në lidhje me Përgjigjen e ZPS-së ndaj Parashtrimit F00428*, 15 shtator 2025, konfidenciale.

<sup>13</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 39(3).

ecurinë e procesit të Dhomave të Specializuara ("DHS"), ose të kryejë vepra penale të mëtejshme. Si alternativë, sipas Mbrojtjes së Fazliut, çdo rrezik që Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund të gjykojë se ekziston, mund të zvogëlohet mjaftueshëm me anë të kushteve që propozon Mbrojtja e Fazliut dhe kushteve të tjera të arsyeshme që Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund të vendosë.<sup>14</sup>

8. Mbrojtja e Fazliut parashtron se, në kuadër të rishikimit të paraburgimit, nuk kundërshton ekzistencën e dyshimit të bazuar sipas nenit 39(2) të Ligjit.<sup>15</sup>

9. Sa i takon rrezikut të arratisjes, Mbrojtja e Fazliut parashtron se pesha që Gjykatësja e Procedurës Paraprake u dha faktorëve të ndryshëm mbi të cilët bazohet ky rrezik, nuk pasqyron saktë rrethanat e z. Fazliu.<sup>16</sup> Konkretisht, sipas Mbrojtjes së Fazliut: (i) z. Fazliu nuk ka "karrierë të gjatë politike", por është i përfshirë në sferën politike vetëm si anëtar i rregullt i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe njihet publikisht vetëm përmes vëllezërve të ndjerë të tij;<sup>17</sup> (ii) lidhjet e z. Fazliu me ish-komandantët e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës ("UÇK") janë vetëm në këtë kontekst dhe ai nuk do të përdorte kujtimin e vëllezërve të tij të ndjerë për të siguruar mjete dhe mbështetje për t'u arratisur;<sup>18</sup> dhe (iii) z. Fazliu është qytetar që respekton ligjin dhe nuk ka demonstruar më parë "shpërfillje të hapur ndaj ligjeve dhe rregulloreve të DHS-së", me përjashtim të akuzave aktuale të kontestuara.<sup>19</sup> Krahas kësaj, Mbrojtja e Fazliut parashtron se nuk mund ta kundërshtojë ose t'i japë kontekst informacionit të dorëzuar nga ZPS-ja në të cilin u mbështet vendimi i parë i Gjykatësës së Procedurës Paraprake, pasi nuk ka qasje në shtojcën përkatëse e as në provat e identifikuar.<sup>20</sup> Së fundi, Mbrojtja e Fazliut parashtron se z. Fazliu synon

---

<sup>14</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 1, 9-35, 38 dhe Shtojcat 1-3 që u bashkëlidhen atyre.

<sup>15</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 8.

<sup>16</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 9-10.

<sup>17</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 11-14.

<sup>18</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 14-15.

<sup>19</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 19-20.

<sup>20</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 10, poshtëshënimi 11, që i referohet [Decision on Arrest](#), (Vendimi i Arrestimit) para. 83, poshtëshënimi 116, që citon KSC-BC-2012, F00023/SCONF/RED, Prokurorja e Specializuar, *Version i Redaktuar Konfidencial i Parashtrimeve të Prokurorisë në bazë të*

të përballet me akuzat në gjykatë, e jo të arratiset, dhe se dijenia e tij për akuzat e rënda kundër tij dhe dënimin e mundshëm, si edhe provat e "pamjaftueshme dhe jothelbësore" kundër z. Fazliu, duhet të interpretohen pikërisht brenda këtij konteksti.<sup>21</sup>

10. Sa i takon rrezikut të pengimit dhe të kryerjes së veprave penale të mëtejshme, Mbrojtja e Fazliut parashtron se z. Fazliu: (i) nuk ka lidhje apo ndikimin për të nxitur besnikëri dhe mundësuar pengim të procesit;<sup>22</sup> (ii) nuk ka mjete financiare për të penguar procesin;<sup>23</sup> dhe (iii) nuk ka asnjë motiv për t'u përfshirë në veprime që mund të interpretohen si pengim i procesit.<sup>24</sup> Mbrojtja e Fazliut gjithashtu parashtron se konstatimi lidhur me "këmbënguljen dhe prirjen" e pretenduar të z. Fazliu për pengim të procesit të DHS-së nuk mbështetet nga provat dhe duket se është deduktuar nga rrethanat e përgjithshme.<sup>25</sup> Së fundi, Mbrojtja e Fazliut thekson se: (i) provat kundër z. Fazliu janë ekskluzivisht dokumentare; (ii) hapat hetimorë të papërfunduar nuk kanë të bëjnë me dëshmitarë; dhe (iii) z. Fazliu nuk mund të ndikojë në integritetin e provave, pasi materiali burimor është në posedim të ZPS-së.<sup>26</sup>

11. Së fundi, Mbrojtja e Fazliut parashtron se kushtet dhe zotimet që ka propozuar z. Fazliu dhe djali i tij do të zvogëlonin, në mos pakësonin, çdo rrezik që Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund të gjykojë se ekziston.<sup>27</sup> Në veçanti, Mbrojtja e Fazliut parashtron se një anëtar i familjes ka ofruar garanci financiare prej 40.000 eurosh, i cili gjithashtu është i gatshëm të ofrojë shtëpinë e vet si kolateral, dhe se të dyja do

---

*Urdhrit F00022, konfidencial, 27 nëntor 2024, para. 7 (që i referohet Shtojcës 2 të Parashtrimit F00023 dhe materialeve SITF00172947-00172951; SPOE00360305-00360342; SPOE00360396-00360399; SPOE00360381-00360395; SPOE00360381-SPOE00360395-ET).*

<sup>21</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 21.

<sup>22</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 23, 35.

<sup>23</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 29, 35.

<sup>24</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 30, 35.

<sup>25</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 32-33, 36.

<sup>26</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 34, 35.

<sup>27</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 16-17, 25-28, 35.

t'i konfiskohen në qoftë se shkelen kushtet e lirimit.<sup>28</sup> Sipas Mbrojtjes së Fazliut, kjo i jep z. Fazliu motiv të fortë për të respektuar çdo kusht të caktuar nga DHS-ja.<sup>29</sup> Mbrojtja e Fazliut më tej parashtron se Fahri Fazliu ("z. F. Fazliu"), ndër të tjera, ka dhënë garanci me shkrim se nuk do të mbështesë dhe as mbrojë z. Fazliu për shkelje të kushteve të lirimit, dhe do ta inkurajojë atë që të paraqitet në gjykatë.<sup>30</sup>

## B. PËRGJIGJJA E ZPS-SË

12. ZPS-ja përgjigjet se z. Fazliu përsërit argumentet e veta të mëparshme dhe thjesht nuk pajtohet me konstatimet e mëparshme të Gjykatësës së Procedurës Paraprake.<sup>31</sup> Sipas ZPS-së, nuk ka faktorë e as zhvillime të reja të rëndësishme që do të ndikonin në konstatimet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në Vendimin e Katërt të Rishikimit të Paraburgimit.<sup>32</sup> Rrjedhimisht, ZPS-ja parashtron se kërkesa për lirim me kusht duhet të hidhet poshtë dhe se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet të urdhërojë vazhdimin e paraburgimit të z. Fazliu.<sup>33</sup>

13. Më konkretisht, ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit të z. Fazliu mbetet i domosdoshëm pasi vazhdojnë të ekzistojnë që të tre rreziqet sipas nenit 41(6)(b) i Ligjit.<sup>34</sup> Sa i takon rrezikut të arratisjes, ZPS-ja parashtron se z. Fazliu përpiqet të minimizojë pozitën e tij në Kosovë, brenda UÇK-së dhe me të bashkakuzuarit.<sup>35</sup> Sa i takon pretendimit të Mbrojtjes së Fazliut se provat kundër tij janë të pamjaftueshme dhe jothelbësore, ZPS-ja argumenton se: (i) cilësia dhe fuqia e pretenduar e provave të saj - gjithnjë në rritje për shkak të procesit në vijimësi të nxjerrjes së provave - nuk janë relevante për aspektin e vazhimit të paraburgimit.<sup>36</sup>

---

<sup>28</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 18, 27.

<sup>29</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 18.

<sup>30</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 26.

<sup>31</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 1-5, 6-18.

<sup>32</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 4.

<sup>33</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 4, 20.

<sup>34</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 1, 4.

<sup>35</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 7.

<sup>36</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 9.

14. Sa i takon rrezikut të pengimit të ecurisë së proceseve të DHS-së, ZPS-ja parashtron se Mbrojtja e Fazliut përgjithësisht nuk i trajton faktorët e shqyrtuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në Vendimin e Katërt të Rishikimit të Paraburgimit, ndërsa përsërit se nuk ka lidhje e as ndikim dhe përpiket të mbështetet në kushte të cilat është konstatuar se nuk janë të përshtatshme.<sup>37</sup> Në përgjigje të argumentit të Mbrojtjes së Fazliut se dijenia e z. Fazliu për synimin pengues të z. Thaçi në vetvete nuk është "demonstruar", por është "deduktuar", ZPS-ja argumenton se Mbrojtja e Fazliut: (i) shpërfill provat në dokumentacionin gjyqësor; dhe (ii) nuk trajton njohjen gjithnjë e më të plotë të z. Fazliu me provat inkriminuese kundër tij, por thjesht argumenton se nuk mund të vë në dyshim integritetin e tyre.<sup>38</sup>

15. Sa i takon lirimit me kusht, ZPS-ja parashtron se asnjë kusht i mundshëm - përfshirë kushtet e reja që propozon Mbrojtja e Fazliut - nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.<sup>39</sup> ZPS-ja argumenton se kushtet që propozon Mbrojtja e Fazliut në thelb nuk dallojnë nga masat që janë shqyrtuar dhe hedhur poshtë më parë.<sup>40</sup> Krahas kësaj, ZPS-ja parashtron se përkundër zotimeve që u bashkëlidhen Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut, vazhdon të jetë relevant fakti se z. Fazliu do të ketë ende motivin, aftësinë dhe mundësinë për të kontaktuar dëshmitarë përmes djalit të tij. Rrjedhimisht, ZPS-ja rithekson se këto rreziqe mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së.<sup>41</sup>

16. Sa i takon proporcionalitetit, ZPS-ja parashtron se koha që ka kaluar që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit nuk e bën joproporcional paraburgimin e z. Fazliu.<sup>42</sup> Gjithashtu, ZPS-ja nënvizon se: (i) ndaj z. Fazliu janë

---

<sup>37</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 10.

<sup>38</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 11.

<sup>39</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 15.

<sup>40</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 15.

<sup>41</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 16.

<sup>42</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 17.

ngritur dy akuza për vepra penale sipas nenit 15(2) dhe ai mund të dënohet me burgim të gjatë nëse shpallet fajtor; dhe se (ii) procesi po vazhdon të kryhet me ritëm të shpejtë, sikurse konfirmohet nga një sërë zhvillimesh procedurale në këtë çështje gjyqësore.<sup>43</sup>

### C. KUNDËRPËRGJIGJJA E FAZLIUT

17. Në Kundërpërgjigje, Mbrojtja e Fazliut parashtron se nuk kundërshton elementet që Gjykatësja e Procedurës Paraprake i evidentoi si relevante, por synon t'i paraqesë Gjykatësës së Procedurës Paraprake informacion shtesë që do të mundësonte një vlerësim të bazuar në më shumë informacion të faktorëve që ka shqyrtuar.<sup>44</sup> Për shembull, Mbrojtja e Fazliut pretendon se informacioni i paraqitur së fundmi në lidhje me garancitë e propozuara, është kyç për të vlerësuar nëse këto garanci mund të shërbejnë si faktor shkurajues kundrejt rrezikut të arratisjes.<sup>45</sup> Mbrojtja e Fazliut rithekson ndikimin "e parëndësishëm" të z. Fazliu sa u përket rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.<sup>46</sup>

18. Në lidhje me proporcionalitetin, Mbrojtja e Fazliut argumenton se ecuria e shpejtë e procesit dhe fakti që çështja është shumë afër kalimit të saj trupit gjykues, në vetvete nuk janë faktorë relevantë: ndonëse vonesat e papërligjura do të shkonin në favor të lirimit, mungesa e vonesave thjesht nuk jep arsye shtesë për lirim.<sup>47</sup> Së fundi, sa u takon provave të ZPS-së, Mbrojtja e Fazliut pretendon se komenti i saj nuk kishte të bënte me fuqinë por me vëllimin e provave kundër z. Fazliu, dhe se ai u bë për të shpjeguar pse z. Fazliu do të preferonte t'i dorëzohej drejtësisë sesa t'i ikte procesit.<sup>48</sup>

---

<sup>43</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 17.

<sup>44</sup> Kundërpërgjigja e Fazliut, para. 3, 5-6.

<sup>45</sup> Kundërpërgjigja e Fazliut, para. 7-8.

<sup>46</sup> Kundërpërgjigja e Fazliut, para. 10.

<sup>47</sup> Kundërpërgjigja e Fazliut, para. 13.

<sup>48</sup> Kundërpërgjigja e Fazliut, para. 16.

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

19. Sipas nenit 41(6) të Ligjit, DHS-ja urdhëron arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur: (a) ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprë penale brenda juridiksionit të DHS-së; dhe (b) ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një veprë penale, ose do të pengojë ecurinë e procesit penal nëpërmjet ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryerësit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një veprë penale të tentuar, ose do të kryejë një veprë penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

20. Sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formë të prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve nga vendimi i fundit mbi paraburgimin, paneli i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

21. Sipas nenit 41(12) të Ligjit, krahas masës së paraburgimit, për të siguruar praninë e të akuzuarit, përfshirë përmes videokonferencës, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, ose për të siguruar kryerjen e suksesshme të procesit penal, DHS-ja mund të urdhërojë masat në vijim: fletëthirrjen, arrestimin, dorëzimin, arrestin shtëpiak, premtimin për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimin për t'iu afruar vendeve apo personave të caktuar, paraqitjen në stacion të policisë apo në ndonjë vend tjetër, dhe masa alternative shmangëse.

22. Sipas rregullës 56(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes dhe, në rast të ndonjë vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, pasi ka dëgjuar palët, paneli mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

#### IV. DISKUTIM

##### A. STANDARDI I ZBATUESHËM

23. Standardi i zbatueshëm për rishikimin e paraburgimit është shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme dhe përfshihet në këtë vendim përmes referencave.<sup>49</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake do ta zbatojë këtë standard në këtë vendim.

##### B. DYSHIMI I BAZUAR

24. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se në Vendimin e Konfirmimit u konstatua se, në bazë të nenit 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Fazliu është penalisht përgjegjës për vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së, konkretisht tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe mosbindje ndaj gjykatës sipas neneve 401(2) dhe (5), dhe 393 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074, në shkelje të nenit 15(2) të Ligjit.<sup>50</sup> Këto konstatime u bënë mbi bazën e një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.<sup>51</sup> Gjykatësja e Procedurës

---

<sup>49</sup> *Shih* [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 24-25 (kriteret e përgjithshme), 26 (dyshimi i bazuar), 29-32 (domosdoshmëria), 47 (lirimi me kusht) dhe 53 (proporcionaliteti), dhe referencat që citohen aty; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 10-11 (kriteret e përgjithshme), 12-14 (dyshimi i bazuar), 15-18 (domosdoshmëria e paraburgimit), 32 (lirimi me kusht) dhe 37 (proporcionaliteti), dhe referencat që citohen aty.

<sup>50</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 313(b).

<sup>51</sup> [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 12; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 20; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 27; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 13; [Decision on Arrest](#) (Vendimi i Arrestimit), para. 43. [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 42-43. *Shih, ngjashëm*, KSC-BC-2020-04, F00075/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shala](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), 10 shtator 2021, publik, para. 22; F00224, F00075/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shala](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), 22 qershor 2022, publik, para. 24;

Paraprake vëren se në këtë çështje gjyqësore nuk ka pasur zhvillime që do t'i shfuqizonin këto konstatime.

25. Rrjedhimisht, në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Fazliu ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të DHS-së, të përcaktuara në nenin 41(6)(a) të Ligjit.<sup>52</sup>

### C. DOMOSDOSHMËRIA E PARABURGIMIT

#### 1. Rreziku i arratisjes

26. Në lidhje me rrezikun e arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake para së gjithash rikujton të gjitha aspektet e shqyrtuara në Vendimin e Katërt të Rishikimit, përkatësisht: (i) dijeninë e z. Fazliu për akuzat e rënda kundër tij së bashku me dënimin e mundshëm për këto vepra penale në qoftë se shpallet fajtor; (ii) shpërfilljen e hapur që ai ka treguar ndaj ligjeve dhe rregulloreve të DHS-së; (iii) faktin se z. Fazliu ka mundësi të arratiset duke udhëtuar lirisht në juridiksione ku nuk mund të kapet nga DHS-ja; (iv) fakti që ai gjithashtu ka mjetet për t'iu shmangur drejtësisë, për shkak të karrierës së gjatë politike në Kosovë dhe lidhjeve të ngushta me ish-komandantë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"), përfshirë me veteranë me ndikim të rrënjosur politik – mes të cilëve z. Thaçi – prej të cilëve mund të kërkojë dhe sigurojë mjete dhe mbështetje për t'u arratisur; dhe (v) fakti se, që nga arrestimi i tij, z. Fazliu është në dijeni të provave kundër tij të paraqitura në mbështetje të Aktakuzës, dhe po

---

<sup>52</sup> *Shih, ngjashëm, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 13; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 21; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 28; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 14; Vendimi mbi Paraburgimin në Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 67, rreshtat 8-10.*

informohet në vijimësi - përmes procesit të nxjerrjes së provave – për tërësinë e provave të sjelljes kriminale të pretenduar të tij.<sup>53</sup>

27. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Fazliut kundërshton peshën që iu dha faktorëve të ndryshëm në të cilët mbështetet ky rrezik dhe pretendon se ajo nuk pasqyron saktë rrethanat e z. Fazliu.<sup>54</sup>

28. Fillimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nënvizon se, kur bën rishikimin e paraburgimit, ajo mund t'u referohet konstatimeve në vendimet e mëparshme nëse është bindur se provat ose informacioni ku u bazuan ato vendime vazhdojnë të mbështesin konstatimet e bëra në kohën e rishikimit.<sup>55</sup>

29. Duke iu kthyer argumentit konkret të Mbrojtjes së Fazliut, Gjykatësja e Procedurës Paraprake së pari konstaton se, sa i përket kërkesës së Mbrojtjes së Fazliut për t'i dhënë tjetër peshë faktorëve si karrierës politike të z. Fazliu ose lidhjeve të tij me anëtarë të UÇK-së, përfshirë me z. Thaçi, informacioni që dha Mbrojtja e Fazliut nuk zhvlerëson informacionin mbi të cilin u bazuan konstatimet e mëparshme të Gjykatësës së Procedurës Paraprake lidhur me karrierën politike ose lidhjet e tij.<sup>56</sup> Për më tepër, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se në këtë

---

<sup>53</sup> Shih [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 14; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 22; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 33; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 21; [Decision on Arrest](#) (Vendimi i Arrestimit), para. 81. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se, që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit, ZPS-ja ka nxjerrë materiale shtesë sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores. Shih Paketat 59, 61, 64, 68, 70, 71, 74 dhe 76 të materialeve të nxjerra.

<sup>54</sup> Shih më lart, para. 9, 17.

<sup>55</sup> Shih, *ngjashëm*, KSC-BC-2020-04, IA003/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Pjetër Shala's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit), 11 shkurt 2022, publik, para. 18, dhe referencat që citohen aty.

<sup>56</sup> Shih Vendimin mbi Paraburgimin në Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 67, rreshtat 15-25. [Decision on Arrest](#) (Vendimi i Arrestimit), para. 83. Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, materiali bazë që përmendet në para.8 të [Decision on Arrest](#) (Vendimi i Arrestimit) është në dispozicion të Mbrojtjes së Fazliut, shih KSC-BC-2023-12, F00069/A01, Prokurorja e Specializuar, *Version i Redaktuar Konfidencial i Shtojcës 2 të Parashtrimeve të Prokurorisë në bazë të Urdhrit F00022*, 9 dhjetor 2024, konfidencial.

fazë mbeten të pandryshuara konstatimet e saj mbi faktorë të tjerë, si mundësia e z. Fazliu për t'u arratisur jashtë Kosovës, aftësia e tij për të kontaktuar bashkëpunëtorë për të siguruar mjete dhe mbështetje për t'u arratisur, si dhe njohja gjithnjë e më e plotë e tij me dokumentacionin provues kundër tij. Kjo vazhdon të vlejë përkundër përpjekjes së z. Fazliu për të zhvlerësuar konstatimin se ai tregoi shpërfillje të hapur ndaj ligjeve dhe rregulloreve të DHS-së,<sup>57</sup> si dhe zotimeve të tij për të dorëzuar një dokument identifikues shtesë.<sup>58</sup>

30. Së dyti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se - sikurse pranon vetë Mbrojta e Fazliut - cilësia dhe fuqia e pretenduar e provave të ZPS-së në këtë çështje gjyqësore janë aspekte për të cilat do të merret vendim gjatë gjykimit.<sup>59</sup> Në kuadër të rishikimit të paraburgimit, e rëndësishme është që z. Fazliu vazhdon të njihet mjaftueshëm me provat kundër tij përmes procesit në vijimësi të nxjerrjes së provave - faktor ky që është drejtpërdrejt relevant për vlerësimin e motivit të tij për t'u arratisur.

31. Së treti, sa i takon argumentit të Mbrojtjes së Fazliut se z. Fazliu do të preferonte të përballej me akuzat në gjykatë sesa të arratisëj, si edhe pretendimit se z. Fazliu nuk do të përdorte kurrë kujtimin e vëllezërve për t'u arratisur, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se konstatimet në lidhje me rrezikun e arritjes bazohen në vlerësimin nëse i akuzuari ka motivin për t'u arratisur dhe mjete praktike për t'u arratisur. Deklaratat e të akuzuarit lidhur me synimin ose

---

<sup>57</sup> *Shih*, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 28; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 22; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 33; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 28; [Decision on Arrest](#) (Vendimi i Arrestimit), para. 81.

<sup>58</sup> *Shih* Vendimin mbi Paraburgimin në Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 67, rreshtat 17-21. [Decision on Arrest](#) (Vendimi i Arrestimit), para. 82.

<sup>59</sup> *Shih* Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 33; *shih gjithashtu* KSC-BC-2023-12, IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Isni Kilaj's Appeal Against Third Decision on Review of Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit të Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit) ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt"), 1 shtator 2025, publik, para. 52.

reputacionin e tij nuk mund të zëvendësojnë vlerësimin objektiv të ekzistencës së këtij rreziku.

32. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se konstatimet në Vendimin e Katërt të Rishikimit të Paraburgimit vazhdojnë të jenë të vlefshme, dhe është edhe më tej e bindur se faktorët në favor të z. Fazliu janë të pamjaftueshëm për zvogëlimin e rrezikut të arratisjes.

33. Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se rreziku që z. Fazliu të arratiset vazhdon të ekzistojë.

## 2. Rreziku i pengimit të ecurisë së proceseve të DHS-së

34. Në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se vazhdojnë të vlejnjë të gjitha konstatimet e bëra në Vendimin e Tretë të Rishikimit, përkatësisht ( dhe marrë së bashku): (i) natyra e akuzave të konfirmuara kundër z. Fazliu i cili ishte pjesëtar i një grupi të drejtuar nga z. Thaçi që synonte të ndikonte në mënyrë të paligjshme ndaj dëshmitarëve;<sup>60</sup> (ii) dijenia që ka demonstruar z. Fazliu lidhur me synimet penguese të z. Thaçi, si dhe synimi i tij për realizimin e tyre; (iii) këmbëngulja dhe gatishmëria e tij për pengimin e proceseve të DHS-së përmes realizimit të interesave dhe urdhrave të udhëheqjes së lartë të UÇK-së; (iv) aftësia e tij për të marrë pëlqimin e personave që janë besnik ndaj tij, përfshirë të djalit të tij, me qëllimin e pengimit të proceseve të DHS-së; dhe (v) dijenia gjithnjë e më e plotë e tij lidhur me provat inkriminuese kundër tij.<sup>61</sup>

---

<sup>60</sup> *Shih* [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 16; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 27; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 38; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 24.

<sup>61</sup> *Shih* [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 16; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 27; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 38; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 24-25.

35. Siç është konstatuar më parë,<sup>62</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut lidhur me karrierën politike dhe lidhjet e z. Fazliu me anëtarë të UÇK-së, përfshirë me z. Thaçi,<sup>63</sup> nuk zhvlerësojnë konstatimet e mëparshme të saj mbi aftësinë e z. Fazliu për të siguruar mbështetjen e personave që janë besnik ndaj tij. Po kështu, Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut lidhur me mosnjohjen e pretenduar të z. Fazliu me persona për të cilët ka interes në proceset e DHS-së, nuk mbështesin pretendimin se ai nuk ka mjete për të kryer pengim.<sup>64</sup> Për më tepër, siç është konstatuar më parë,<sup>65</sup> deklaratat e të akuzuarit lidhur me synimin,<sup>66</sup> nuk mund të zëvendësojnë vlerësimin objektiv të ekzistencës së rrezikut të pengimit. Sa i takon kundërshtimeve të Mbrojtjes së Fazliut lidhur me provat,<sup>67</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson për Mbrojtjen e Fazliut konstatimet e mëparshme të saj mbi këmbënguljen dhe prirjen e tij për të penguar procesin e DHS-së<sup>68</sup>dhe dijeninë e tij për synimin pengues të z. Thaçi.<sup>69</sup>

36. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se rreziku i pengimit nuk ka pushuar së ekzistuari me përfundimin e paraqitjes së provave nga ZPS-ja në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve* ("Çështja 06"), sepse procesi vazhdon, dhe (i) sipas rregullës 136 të Rregullores, në rrethana të jashtëzakonshme, Trupi Gjykses mund të dëgjojë prova shtesë pas mbylljes së paraqitjes së provave; dhe (ii) dëshmitarët që kanë dëshmuar tashmë mund të jenë objekt i hakmarrjes ose të nxiten të tërheqin dëshmitë e tyre.<sup>70</sup> Gjykatësja e

---

<sup>62</sup> *Shih më lart*, para. 29.

<sup>63</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 23, 24. *Shih gjithashtu* Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para.11-15.

<sup>64</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 29.

<sup>65</sup> *Shih më lart*, para. 31.

<sup>66</sup> *Shih* Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 24-25, 28-30.

<sup>67</sup> *Shih* Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 32-33.

<sup>68</sup> *Shih* [Decision on Arrest](#) (Vendimi i Arrestimit), para. 86. Vendimi mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 68, rreshtat 3-7.

<sup>69</sup> *Shih* [Decision on Arrest](#) (Vendimi i Arrestimit), para. 86.

<sup>70</sup> [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 16; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 29. *Shih* [Second Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 74, dhe referencat që citohen aty.

Procedurës Paraprake më tej rikujton se rreziku i pengimit nuk vlerësohet vetëm në raport me Çështjen 06, por edhe në raport me këtë çështje gjyqësore.<sup>71</sup> Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit, ZPS-ja ka dorëzuar listën e dëshmitarëve të vet.<sup>72</sup> Pasi ka analizuar profilin e dëshmitarëve të ZPS-së të përfshirë në këtë listë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson se rreziku i ndërhyrjes ndaj këtyre dëshmitarëve të ZPS-së është i ulët. Megjithatë, kjo nuk zhvlerëson përfundimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në Vendimin e Katërt të Rishikimit të Paraburgimit se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit, duke mbajtur parasysh të gjithë faktorët e tjerë në të cilët u mbështet ky përfundim.<sup>73</sup>

37. Gjykatësja e Procedurës Paraprake më tej rikujton se nuk është e nevojshme që rreziku i pengimit të materializohet përmes kontaktimit të dëshmitarit 1 dhe/ose dëshmitarëve të tjerë personalisht prej z. Fazliu, por ky rrezik mund të materializohet, për shembull, përmes bashkërendimit të mëtutjeshëm të z. Fazliu me djalin e vet dhe/ose bashkëpunëtorët e tjerë nga rrjeti i tij në UÇK dhe/ose qarqet politike të tij.<sup>74</sup> Sa i takon bashkërendimit të mëtutjeshëm me z. F. Fazliu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se garancitë e dhëna nga z. F. Fazliu,<sup>75</sup> ndonëse

---

*Shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-06, IA033/F00006, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Rexhep Selimi's Appeal Against Consolidated Decision on Request for Provisional Release and on Review of Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit Përmbledhës në lidhje me Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe Rishikimin e Paraburgimit), 13 gusht 2025, publik, para. 55, 54. IA035/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Jakup Krasniqi's Appeal Against Consolidated Decision on Request for Provisional Release and on Review of Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit Përmbledhës në lidhje me Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe Rishikimin e Paraburgimit), 13 gusht 2025, publik, para. 34.

<sup>71</sup> [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 19; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 22.

<sup>72</sup> KSC-BC-2023-12, F00459/A03, Prokurorja e Specializuar, *Shtojca 3 e Parashtrimit prej Prokurorisë të Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale*, 19 shtator 2025, konfidenciale. Lista e dëshmitarëve u ridorëzua më 26 shtator 2025, me numër parashtrimi F00467/A03, pas dorëzimit të versionit të korigjuar të Dosjes Paraprake.

<sup>73</sup> [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 18.

<sup>74</sup> *Shih më lart*, para. 26 [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 28; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 39; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 25, dhe referencat që citohen aty.

<sup>75</sup> *Shih Shtojcën 3 të Parashtrimeve të Mbrojtjes*.

të gjëra dhe përfshijnë zotimin e tij se ai nuk do të mbështesë ose mbrojë z. Fazliu për shkelje të kushteve të lirimit, janë të pamjaftueshme për të eliminuar gjasat e këtij rreziku.

38. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nënvizon se vazhdon t'i vlerësojë faktorët e mësipërm në kontekstin e atmosferës së përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve aktualë dhe të mundshëm të DHS-së.<sup>76</sup> Në këtë kontekst, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbetet e bindur se rreziku se z. Fazliu do të ushtrojë presion mbi dëshmitarët vazhdon të jetë veçanërisht i lartë,<sup>77</sup> duke pasur parasysh lidhjet e tij të përmendura më lart.<sup>78</sup>

39. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku se z. Fazliu do të pengojë ecurinë e proceseve penale.

### 3. Rreziku i kryerjes së veprave penale të mëtejshme

40. Sa i takon rrezikut të kryerjes së veprave penale të mëtejshme sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, edhe pse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së veprave penale të mëtejshme, në këto rrethana, faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë relevantë edhe për vlerësimin e këtij të dytit.<sup>79</sup> Në

---

<sup>76</sup> [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 17; [Third Review Decision](#) (Vendimi Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 30; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 40; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 26; [Decision on Arrest](#) (Vendimi i Arrestimit), para. 63, dhe referencat që citohen aty. Shih gjithashtu [Second Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 83.

<sup>77</sup> Shih [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 17; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 30; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 40, dhe referencat që citohen aty; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 26.

<sup>78</sup> Shih më lart, para 26.

<sup>79</sup> Shih [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 19; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 32; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 43; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 28.

këtë kontekst, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se faktorët relevantë - të cilët duhen vlerësuar bashkërisht - janë të njëjtë me faktorët e përshkruar në paragrafët 34-38 më lart në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit. Pasi ka shqyrtuar sërish këta faktorë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbetet e bindur se ende ekziston rreziku se z. Fazliu do të përsërisë veprat penale që pretendohet se ka kryer,<sup>80</sup> përfshirë në lidhje me dëshmitarë që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në gjykimin e Çështjes 06 dhe/ose në këtë çështje gjyqësore.<sup>81</sup>

41. Bazuar në sa më lart, dhe në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi të ri që tregon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se ende vazhdon të ekzistojë rreziku se z. Fazliu do të kryejë vepra penale të mëtejshme.

#### 4. Përfundim

42. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdojnë të ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se z. Fazliu mund të arratiset, të pengojë ecurinë e proceseve të DHS-së, ose të kryejë vepra penale të mëtejshme, çka e bën të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit të z. Fazliu, në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit. Në vijim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të vlerësojë nëse kushtet për lirimin e z. Fazliu mund të zvogëlojnë mjaftueshëm këto rreziqe.

#### D. LIRIMI ME KUSHT

43. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e mëparshëm se asnjë prej kushteve të propozuara nga Mbrojtja e Fazliut dhe asnjë kusht i arsyeshëm

---

<sup>80</sup> *Shih* [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 19; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 32; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 43; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 28; [Decision on Arrest](#) (Vendimi i Arrestimit), para. 90. Vendimi mbi Paraburgimin, f. 68, rreshtat 3-7.

<sup>81</sup> *Shih më lart*, para. 34.

shtesë i caktuar *proprio motu* nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake,<sup>82</sup> nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese sipas nenit 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.<sup>83</sup>

44. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes së Fazliut se garancitë e propozuara së fundmi<sup>84</sup> dhe kushtet e tjera të propozuara<sup>85</sup> do të ishin faktorë shkurajues për rreziqet sipas nenit 41(6)(b), Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se vlerësimi nëse dorëzania mund të shërbejë si faktor shkurajues duhet të bazohet në dokumentacion në lidhje me gjendjen financiare të të akuzuarit.<sup>86</sup> Në mungesë të këtij dokumentacioni, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se informacioni shtesë i dorëzuar nga Mbrojtja e Fazliut,<sup>87</sup> edhe pse më i hollësishëm, nuk mund të ndryshojë vlerësimin e saj në lidhje me këtë aspekt.

45. Duke mbajtur parasysh konstatimet e mësipërme lidhur me ekzistencën e të tre rreziqeve, dhe pasi ka shqyrtuar si duhet kushtet dhe zotimet e propozuara së fundmi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbetet e bindur se këto kushte: (i) nuk trajtojnë mundësinë që z. Fazliu të përdorë pajisje komunikimi që u përkasin të tjerëve ose t'u kërkojë personave të tjerë të përdorin pajisjet e tyre të komunikimit për këtë qëllim; dhe (ii) nuk mund të garantojnë, për shembull, monitorimin efektiv

---

<sup>82</sup> *Shih, ngjashëm*, KSC-BC-2020-06, IA017/F00011/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit), 5 prill 2022, publik, para. 51.

<sup>83</sup> *Shih* [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 22, 25; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 38, 40; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 52; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 33; Vendimi mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 60, rreshtat 5-19; f. 68, rreshtat 21-23.

<sup>84</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 18, 23-27.

<sup>85</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 16-17.

<sup>86</sup> KSC-BC-2023-12, F00403, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Fourth Decision on Review of Detention of Isni Kilaj](#) (Vendimi i Katërt mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt), 5 gusht 2025, publik, para. 20, 30, poshtëshënimet 32, 45, në lidhje me informacionin që do t'i mundësonte Gjykatësës së Procedurës Paraprake të vlerësonte gjendjen financiare të një të akuzuari (në këtë rast, të Isni Kilajt), dhe rrjedhimisht shumë e përshtatshme për dorëzani.

<sup>87</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 18 dhe referencat që citohen aty; Shtojca 2 e Parashtrimeve të Mbrojtjes; Kundërpërgjigjja e Fazliut, para. 7.

të komunikimeve të z. Fazliu.<sup>88</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake po ashtu mban parasysh se, pavarësisht nga të gjitha kushtet, përfshirë kushtet e propozuara së fundmi, i akuzuari do të ketë aftësinë, motivin dhe mundësinë të kontaktojë dëshmitarë përmes djalit të tij dhe bashkëpunëtorëve të tjerë.<sup>89</sup>

46. Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu mbetet e bindur se: (i) ndonëse rreziku i mesazheve dhe udhëzimeve të paligjshme nuk mund të eliminohet tërësisht, masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të marra në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pambikëqyrura me anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar paraprakisht, me synimin për të zvogëluar, sa më shumë që të jetë e mundur, rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të mëtejshme;<sup>90</sup> dhe se (ii) Administratorja dhe paneli, që kanë qasje të pakufizuar në informacionin konfidencial lidhur me dëshmitarët dhe viktimat, mund të ndërmarrin veprime më shpejt se autoritetet e tjera që veprojnë sipas një kornize të ndryshme.<sup>91</sup>

47. Bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se kushtet për lirimin e z. Fazliu të propozuara më parë nga Mbrojtja e Fazliut dhe/ose çfarëdo kushti i arsyeshëm *shtesë* i caktuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, mbeten të pamjaftueshme për të zvogëluar në masën e duhur rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.

---

<sup>88</sup> *Shih* [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 22; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 38; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 49; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 34.

<sup>89</sup> *Shih më lart*, para. 34, 38.

<sup>90</sup> [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 24; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 39; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 50; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 35.

<sup>91</sup> [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 24; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 39; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 50; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 35.

## E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

48. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se: (i) z. Fazliu është në paraburgim që prej arrestimit të tij më 5 dhjetor 2024; (ii) ndaj tij është ngritur një akuzë për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë për mosbindje ndaj Gjykatës, për të cilat mund të dënohet përkatësisht me deri në pesë (5) vjet e gjashtë (6) muaj burgim;<sup>92</sup> dhe (iii) rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit (në veçanti rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së veprave penale të mëtejshme) nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm me asnjë kusht të propozuar ose kusht shtesë të lirimit.<sup>93</sup>

49. Gjykatësja e Procedurës Paraprake po ashtu mban parasysh se, që prej Vendimit të Katërt të Rishikimit të Paraburgimit: (i) ZPS-ja ka dorëzuar Dosjen Paraprake, Listën e Provave Materiale dhe Listën e Dëshmitarëve më 19 shtator 2025;<sup>94</sup> (ii) ZPS-ja ka nxjerrë material të mëtejshëm sipas rregullave 102(1)(b) dhe 103 të Rregullores;<sup>95</sup> (iii) ZPS-ja ka dorëzuar njoftimin e saj të katërt sipas rregullës 102(3) të Rregullores<sup>96</sup> dhe ka nxjerrë një numër materialesh të kërkuara

---

<sup>92</sup> *Shih* KSC-BC-2023-12, F00264/A02, Prokurorja e Specializuar, [Public Redacted Amended Confirmed Indictment](#) (Version i Redaktuar Publik i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), 16 prill 2025, publik, para. 47.

<sup>93</sup> *Shih më lart*, para. 47.

<sup>94</sup> KSC-BC-2023-12, F00459, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale*, 19 shtator 2025, publik, me Shtojcat 1-5, konfidenciale. Versioni i korrigjuar i Dosjes Paraprake të ZPS-së u dorëzua më 26 shtator 2025, *shih* F00467, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Dosjes Paraprake të Korrigjuar të Prokurorisë*, 26 shtator 2025, publik, me shtojcat 1-5, konfidenciale.

<sup>95</sup> *Shih* Paketat 59, 60-61, 64, 68, 70-71, 74, 76 të materialeve të nxjerra. *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2023-12, F00420, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në bazë të Urdhrit F00395 ("Parashtrimet e ZPS-së për Ecurinë")*, 25 gusht 2025, konfidenciale, para. 2, 3; Version i redaktuar publik u dorëzua më 5 shtator 2025, F00420/RED. Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu vë në dukje se është dorëzuar një kërkesë për nxjerrje të mëtejshme materiali sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, për të cilën ende nuk është marrë vendim (*shih* F00458, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialit sipas Rregullës 102(1)(b)*, 19 shtator 2025, konfidenciale; F00462, Prokurorja e Specializuar, *Sqarim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialit sipas Rregullës 102(1)(b)*, F00458, 23 shtator 2025, konfidencial).

<sup>96</sup> KSC-BC-2023-12, F00417, Prokurorja e Specializuar, [Prosecution's Fourth Rule 102\(3\) Notice](#), (Njoftimi i Katërt i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)), 18 gusht 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

nga Mbrojtja;<sup>97</sup> (iv) ZPS-ja i ka paraqitur Gjykatëses së Procedurës Paraprake pikat faktike për të cilat palët pajtohen, siç parashihet në rregullën 95(3) të Rregullores;<sup>98</sup> (v) hapat e mbetur hetimorë po ecin me ritëm normal,<sup>99</sup> dhe pas kryerjes së tyre pritet nxjerrje e mëtejshme e materialit;<sup>100</sup> (vi) Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka ftuar ekipet e Mbrojtjes që deri më 20 tetor 2025, të dorëzojnë dosjet paraprake dhe të njoftojnë ZPS-në për synimin e tyre për të paraqitur arsye që përjashtojnë përgjegjësinë penale;<sup>101</sup> dhe (viii) Gjykatësja e Procedurës Paraprake informoi palët se synon t'ia kalojë çështjen trupit gjykues në gjysmën e parë të nëntorit 2025, në qoftë se kjo lejohet nga vendimet e ardhshme të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelet e paraqitura në lidhje me mocionet paraprake.<sup>102</sup> Rrjedhimisht, sipas

<sup>97</sup> Shih Paketat 58, 62-63, 65-66, 69, 75 të materialeve të nxjerra. Shih gjithashtu Parashtrimet e ZPS-së për Ecurinë, para. 17, 19.

<sup>98</sup> KSC-BC-2023-12, F00469, Prokurorja e Specializuar, Njoftim në lidhje me Faktet e Pranuara, 29 shtator 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>99</sup> Shih KSC-BC-2023-12, F00407, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Urdhër (F00361) dhe Modalitetet e Mëtejshme për Ekzaminimin e Materialit nga Mbrojtësja e Pavarur, 5 gusht 2025, konfidencial; F00431, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, Vendim mbi Vazhdimin e Fazës 2 të Mekanizimit për Ekzaminimin e Materialit të Ruajtur dhe Çështje në lidhje me Të, 29 gusht 2025, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale; F00432, Mbrojtësja e Pavarur, Paraqitje e Rezultateve Paraprake nga Mbrojtësja e Pavarur, 1 shtator 2025, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcat 2-5, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte; F00433, Administratorja, Parashtrim i Administratores i 130 Dokumenteve Rezultuese nga Termat e Kërkimit 2 dhe 3, sipas Vendimit F00431, dhe Kërkesë për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin prej Kompanisë për Kriministikë Digjitale të Raportit lidhur me Interpretimin e Meta të Dhënave, 3 shtator 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale; F00434, Mbrojtësja e Pavarur, Përcjellje prej Mbrojtëses së Pavarur e Dokumenteve Rezultuese të Redaktuara sipas Vendimit F00431, 5 shtator 2025, konfidenciale, me Shtojcat 1-11, konfidenciale; F00437, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Informacion të Mëtejshëm nga EFC dhe Informacion nga Zyra Administrative, 8 shtator 2025, konfidencial; F00442, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, Vendim mbi Kërkesën për Shtyrje të Afatit për Dorëzimin prej Kompanisë për Kriministikë Digjitale të Raportit lidhur me Interpretimin e Meta të Dhënave, 9 shtator 2025, konfidencial; F00471, Administratorja, Parashtrim i Raportit të Kompanisë për Kriministikë Digjitale sipas Vendimit F00431, 30 shtator 2025, konfidencial; F00472, Administratorja, Raporti i Tretë Mujor i Administratores sipas Vendimit F00350, 30 shtator 2025 (njoftuar më 1 tetor 2025), konfidencial.

<sup>100</sup> Shih KSC-BC-2023-12, F00368, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Qasje në Material dhe Çështje Përkatëse, 9 korrik, 2025, konfidencial, para. 53, 57(i), me Shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>101</sup> KSC-BC-2023-12, F00453, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on the Remaining Calendar of the Pre-Trial Proceedings](#) (Vendim mbi Pjesën e Mbetur të Kalendarit të Fazës Paraprake) ("Vendimi mbi Kalendarin e Fazës Paraprake"), 16 shtator 2025, publik, para. 17-18.

<sup>102</sup> [Pre-Trial Calendar Decision](#) ("Vendimi mbi Kalendarin e Fazës Paraprake"), para. 23.

mendimit të Gjykatëses së Procedurës Paraprake, procesi po vazhdon të kryhet me ritëm të shpejtë, çka bën që çështja të jetë shumë afër kalimit të saj trupit gjykues.

50. Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka vlerësuar në mënyrë të duhur kohën shtesë që z. Fazliu ka kaluar në paraburgim që nga Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit, por konstaton se – kur krahasohet me faktorë të tjerë të përshkruar në paragrafët 48-49 më lart – paraburgimi i tij mbetet proporcional.

51. Gjithashtu, sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Fazliu do të rishikohet në mënyrë të rregullt pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin ose në çdo kohë, në bazë të një kërkesë apo *proprio motu*, kur ka ndryshime të rrethanave që nga rishikimi i fundit.

52. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se z. Fazliu nuk është mbajtur në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme brenda kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores.

## V. VENDIM

53. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Fazliu;
- b. **URDHËRON** z. Fazliu që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri **të martën, 11 nëntor 2025, në orën 16:00**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores;
- c. **URDHËRON** ZPS-në që, në qoftë se z. Fazliu vendos të mos dorëzojë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të dorëzojë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Fazliu deri **të martën, 18 nëntor 2025, në orën 16:00**, dhe zotin Fazliu, nëse dëshiron, të dorëzojë përgjigjen deri **të martën, 25 nëntor 2025, në orën 16:00**; dhe

